

# Çështje të Lidhura me Procesin e Rregullt Gjyqësor për të Paraburgosurit me Nevoja të Shëndetit Mendor



Shkurt 2024



# Çështje të Lidhura me Procesin e Rregullt Gjyqësor për **të Paraburgosurit** **me Nevoja të Shëndetit Mendor**

Shkurt 2024



## PËRMBAJTJA

1. Hyrje .....	5
2. Metodologjia .....	6
3. Korniza ligjore .....	7
4. Analiza e rasteve.....	10
5. Përmbyllje .....	14
6. Rekomandime .....	15

# 1. Hyrje

Që nga viti 1999, mandati i Misionit në Kosovë të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) ka përfshirë monitorimin e sistemit të drejtësisë në Kosovë në raport me pajtueshmërinë me të drejtën për gjykim të drejtë dhe standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Raportet e monitorimit të gjykimeve bazohen në monitorimin e drejtpërdrejtë të realizuar nga personeli i OSBE-së në gjykatat në mbarë vendin, me fokus në problematikat sistemore që prekin sistemin e drejtësisë.

Ky raport i fokusuar analizon çështjen e paraburgimit në rastet ku të pandehur janë personat me nevoja të shëndetit mendor.<sup>1</sup> OSBE ka raportuar dhe më herët lidhur me përdorimin e masës së paraburgimit<sup>2</sup> dhe ka ngritur shqetësime, përfshirë në veçanti në lidhje me mbajtjen në paraburgim të personave me çrregullime të shëndetit mendor, që janë akoma evidente.<sup>3</sup> Çështja e përdorimit të masës së paraburgimit ka rëndësi të madhe për OSBE-në sepse ka ndikim të madh në të drejtat themelore të njeriut, përfshirë këtu të drejtën për liri. Në rastin konkret të të pandehurve me nevoja të shëndetit mendor, dërgimi i tyre në paraburgim ngre shqetësime të mëtutjeshme për sa i përket trajtimit të mundshëm çnjerëzor dhe poshtëruës të personave në pozitë veçanërisht të cenueshme.

Në vitin 2022, në suazat e monitorimit të drejtpërdrejtë në terren të seancave dëgjimore dhe analizës së propozimeve e aktvendimeve gjegjëse me shkrim për caktim të masës së paraburgimit,<sup>4</sup> OSBE ka vëzhguar një numër rastesh ku të pandehurit ishin persona me probleme të shëndetit mendor dhe ka evidentuar raste të shqiptimit të masës së paraburgimit ndaj personave të tillë, gjë që ngre shqetësime të caktuara në lidhje me trajtimin e të pandehurve me nevoja të shëndetit mendor. Ky raport i fokusuar i analizon rastet dhe shqetësimet në fjalë dhe del me rekomandime përkatëse.

<sup>1</sup> Ky raport nuk ka të bëjë me masën e trajtimit të detyrueshëm apo përdorimin e masës së paraburgimit ndaj personave me probleme të shëndetit mendor si masë sigurie në kuadër të sistemit të drejtësisë penale (d.m.th. paraburgimi i personave për shkak të rrezikut që paraqet shëndeti i tyre mendor), çështje kjo që ka qenë objekt shqyrtimi i studimeve të mëhershme të OSBE-së (shih p.sh. OSBE, Shqyrtime të sistemit të drejtësisë penale: Shqyrtimi i dytë, shkurt 2021, f. 23–26; Shqyrtimi i tretë, nëntor 2021, f. 41–42; Shqyrtimi i katërt, shkurt 2002, f. 52–55; Shqyrtimi i pestë, maj 2003, f. 34–36; Shqyrtimi i shtatë, mars 2006, f. 25).

<sup>2</sup> Shih raportin e OSBE-së me titull “Raport i monitorimit të gjykimeve në lidhje me masën e paraburgimit” (2023). Shih po ashtu raportin e OSBE-së me titull “Përdorimi i paraburgimit në procedurat penale në Kosovë: Shqyrtim dhe analizë gjithëpërfshirëse e brengave të mbetura – Pjesa I”, nëntor 2009”. <https://www.osce.org/files/f/documents/5/5/40584.pdf> (qasur më 18 korrik 2023); dhe raportin e OSBE-së me titull “Përdorimi i paraburgimit në procedurat penale në Kosovë: Shqyrtim dhe analizë gjithëpërfshirëse e brengave të mbetura – Pjesa II”, tetor 2010.

<sup>3</sup> Shih OSBE, Shqyrtime të sistemit të drejtësisë penale: Shqyrtimi i dytë, shkurt 2021, f. 26–28; Shqyrtimi i katërt, shkurt 2002, f. 55–56; Shqyrtimi i pestë, maj 2003, f. 36–37; Shqyrtimi i shtatë, mars 2006, f. 46–47.

<sup>4</sup> Shih raportin e OSBE-së me titull “Raport i monitorimit të gjykimeve në lidhje me masën e paraburgimit”, 2023.

## 2. Metodologjia

Metodologjia e këtij raporti bazohet në sa vijon:

- i. Analizë cilësore e të dhënave të mbledhura nga seancat për caktim të paraburgimit që janë monitoruar nga OSBE në periudhën janar - dhjetor 2022, të kërkesave të prokurorisë, parashtresave të mbrojtjes dhe aktvendimeve gjyqësore për paraburgim; dhe
- ii. Hulumtim i literaturës mbi standardet ndërkombëtare dhe legjislacionin e Kosovës;

Metodologjia e monitorimit të gjykimeve të cilën e kanë përdorur monitoruesit e OSBE-së bazohet në metodën dhe parimet e ODIHR-it për monitorim të gjykimeve, që përshkruhet në doracakun e ODIHR-it për profesionistë të fushës të botuar në vitin 2012.<sup>5</sup>

Për qëllime të këtij raporti, OSBE ka identifikuar pesë nga 70 rastet e monitoruara në periudhën janar - dhjetor 2022 para shtatë gjykatave themelore të Kosovës, ku të pandehurit dyshoheshin se vuanin nga probleme të shëndetit mendor. Aktvendimet e mëpastajme për zgjatje të paraburgimit, ose kohëzgjatja e gjithmbarshme e mbajtjes në paraburgim në rastet në fjalë, nuk kanë qenë objekt i analizës.

---

<sup>5</sup> Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR), *Doracak për monitorim të gjykimeve: Doracak për referencë për profesionistët (botim i rishikuar, 2012)*, <https://www.osce.org/odihr/94216> (qasur më 18 korrik 2023).

## 3. Korniza ligjore

### a. Standardet ndërkombëtare

E drejta për liri është e drejtë themelore e mishëruar si në instrumentet ndërkombëtare ashtu edhe në ato rajonale të të drejtave të njeriut, që përcaktojnë se askush nuk duhet të privohet nga liria, përveç për arsye dhe në përputhje me procedurën e parashikuar me ligj.<sup>6</sup> Në veçanti, paraburgimi duhet të jetë i arsyeshëm dhe i domosdoshëm në të gjitha rrethanat dhe të përbëjë *"përgjithshëm dhe jo rregull i përgjithshëm"*.<sup>7</sup>

Për sa i përket paraburgimit të të pandehurve me nevoja të shëndetit mendor, ekzaminimi i duhur mjekësor i personit që ndodhet në paraburgim duhet të kryhet sa më shpejt që të jetë e mundur dhe t'i ofrohet kujdes i duhur mjekësor i mëpastajmë nëse është e nevojshme.<sup>8</sup> Personat e ndaluar në vazhden e procedurës penale, të cilët janë konstatuar se vuajnë nga një sëmundje mendore duhet të marrin kujdesin më të mirë të disponueshëm për shëndetin mendor<sup>9</sup> dhe, në veçanti, për të mos e përkeqësuar gjendjen e tyre, personat me çrregullime të rënda mendore nuk duhet të mbahen në burgje por në institucione të shëndetit mendor, gjersa rastet më pak të rënda duhet të trajtohen në institucione të specializuara.<sup>10</sup>

Ç'është më e rëndësishme, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) ka konstatuar në shumë raste se mbajtja në paraburgim e personave me nevoja të shëndetit mendor në kushte që nuk e lejojnë ofrimin e kujdesit të duhur për shëndetin mendor, dhe që kanë efekt konkret të dëmshëm në shëndetin mendor të personit në paraburgim, mund të përbëjë trajtim çnjerëzor dhe poshtërues dhe, si rrjedhim, shkelje të nenit 3 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNJ).<sup>11</sup>

---

<sup>6</sup> Shih nenin 9(1) e Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, dhjetor 1966 (PNDKP); nenin 5(1) e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, nëntor 1950 (KEDNJ).

<sup>7</sup> Komiteti i OKB-së për të Drejtat e Njeriut, Koment i përgjithshëm nr. 35 lidhur me nenin 9, dhjetor 2014, paragrafët 12, 38.

<sup>8</sup> Parimi 24 i Grupit të parimeve të OKB-së për mbrojtjen e të gjithë personave nën çfarëdo paraburgimi apo burgimi, dhjetor 1988.

<sup>9</sup> Parimi 20 i Parimeve të OKB-së për mbrojtjen e personave me sëmundje mendore dhe përmirësimin e kujdesit për shëndetin mendor, dhjetor 1991.

<sup>10</sup> Rregulli 109 i Rregullave standarde minimale të OKB-së për trajtimin e të burgosurve, 2015. Shih gjithashtu Parimin 12 të Rekomandimit të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës Rec(2006)2 drejtuar shteteve anëtare mbi rregullat evropiane për burgjet, qershor 2006.

<sup>11</sup> Shih p.sh., Dybeku kundër Shqipërisë, GJEDNJ, Aktgjykim i datës 18 dhjetor 2007; Raffray Taddei kundër Francës, GJEDNJ, Aktgjykim i datës 21 dhjetor 2010; G. kundër Francës, GJEDNJ, Aktgjykim i datës 23 shkurt 2012, MS kundër Mbretërisë së Bashkuar, GJEDNJ, Aktgjykim i datës 3 maj 2012; Rooman kundër Belgjikës, GJEDNJ, Aktgjykim i datës 31 janar 2019 (Dhoma e Madhe).



## b. Korniza ligjore e Kosovës

Në Kosovë, procedurat që rregullojnë paraburgimin përcaktohen me nenet 163, 182-190 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPP).<sup>12</sup>

KPP përcakton se, që nga momenti i arrestimit, nëse personi *“shfaq shenja të çrregullimit mendor, policia mund ta urdhërojë menjëherë kontrollin nga një psikiatër.”*<sup>13</sup> Personi i arrestuar ka gjithashtu të drejtë në trajtim mjekësor, përfshirë edhe trajtimin psikiatrik.<sup>14</sup>

Kapitulli XXXIII i KPP-së u kushtohet procedurave penale që zhvillohen ndaj kryerësve me çrregullime të shëndetit mendor. Sipas nenit 508(1) të KPP-së, në çdo kohë gjatë procedurës, *“nëse ekziston dyshimi se i pandehuri ka qenë në gjendje të paaftësisë mendore ose në gjendje të aftësisë së zvogëluar mendore në kohën e kryerjes së veprës penale apo nëse ka ndonjë çrregullim mendor, gjykata sipas detyrës zyrtare ose me propozimin e prokurorit [...], mund të caktojë ekspert sipas nenit 144 të [KPP] për të kryer ekzaminimin psikiatrik të të pandehurit për të konstatuar nëse:*

*1.1. në kohën e kryerjes së veprës penale i pandehuri ka qenë në gjendje të paaftësisë mendore ose aftësisë së zvogëluar mendore; ose*

*1.2. i pandehuri është i paaftë për të përballuar gjykimin.”*

Pra, kur ekziston dyshimi për çrregullime mendore ose probleme me aftësinë mendore (pavarësisht se a janë të lidhura me veprën e pretenduar), gjykata dhe/ose palët mund të kërkojnë ekzaminim psikiatrik,<sup>15</sup> përfshirë në procedurën për caktim të masës së paraburgimit ose procedurën para ngritjes së aktakuzës.

<sup>12</sup> Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, Kodi nr. 08/L-032 (KPP).

<sup>13</sup> Neni 167(4) i KPP.

<sup>14</sup> Neni 167(2) i KPP.

<sup>15</sup> Vlerësimi psikiatrik zakonisht përdoret në rastet kur dyshohet për sëmundje mendore. Nëse dyshohet për probleme tjera me aftësinë mendore, siç janë vështirësitë në të nxënë, zakonisht më e përshtatshme është të bëhet vlerësim psikologjik. Kjo e fundit varet nga disponueshmëria e psikologëve mjekoligjorë të specializuar.

Neni 509(1) i KPP-së parasheh taksativisht se, përveç rasteve nga neni 184, paraburgimi mund të urdhërohet nëse:

- i. ekziston dyshim i bazuar se i pandehuri ka kryer veprë penale;
- ii. ekzaminimi psikiatrik konstaton se personi ka qenë në gjendje të paaftësisë mendore ose në gjendje të aftësisë së zvogëluar mendore në kohën e kryerjes së veprës penale; dhe
- iii. personi aktualisht vuan nga çrregullimi mendor dhe, si rezultat i kësaj, ka arsye për të besuar se ai do të rrezikojë jetën apo shëndetin e ndonjë personi tjetër.

Në këtë rast, ose kur i pandehuri tashmë ndodhet në paraburgim dhe ndërkohë konstatohet se vuan nga një çrregullim i shëndetit mendor, paraburgimi duhet të mbahet në një institucion të kujdesit shëndetësor.<sup>16</sup> Në të dyja rastet është obligative që gjykata të nxjerrë aktvendim të tillë pas shqyrtimit të mendimit të ekspertit psikiatrik.<sup>17</sup>

---

<sup>16</sup> Neni 509(2) dhe (3) i KPP.

<sup>17</sup> Neni 509(4) i KPP.

## 4. Analiza e rasteve

Nga 70 rastet e monitoruara për qëllime të këtij raporti, OSBE ka evidentuar pesë të pandehur të cilët dyshoheshin, ose ishin konstatuar se vuanin nga çrregullime mendore (d.m.th. shtatë për qind e mostrës). Që të pesë të pandehurit janë meshkuj shqiptarë të Kosovës të cilët janë ndjekur penalisht për vepra të ndryshme penale.<sup>18</sup>

### Llojet e rasteve me të pandehur me probleme të shëndetit mendor




Tabela Nr.1. Llojet e rasteve me të pandehur me probleme të shëndetit mendor

Për tre nga pesë të pandehurit, prokuroria nuk ka kërkuar ekzaminim psikiatrik megjithëse gjendja e shëndetit mendor apo dyshimi për çrregullime mendore të këtyre të pandehurve është përmendur në kërkesat e tyre për caktim të paraburgimit.

<sup>18</sup> Një rast është shqyrtuar në Gjykatën Themelore në Mitrovicë dhe ka të bëjë me veprën penale lëndim i lehtë trupor (dhunë në familje); një është shqyrtuar në Gjykatën Themelore në Gjilan dhe ka të bëjë me veprën penale asgjësim apo dëmtim i pasurisë; një është shqyrtuar nga Gjykata Themelore në Pejë dhe ka të bëjë me veprën penale sulmi seksual në lidhje me dhunën në familje; dhe dy sosh janë shqyrtuar nga Gjykata Themelore në Gjakovë, njëri në lidhje me veprën penale vrasje në tentativë dhe tjetri për veprën penale dhunë në familje.

Në dy nga rastet në fjalë, gjegjësisht në rajonin e Mitrovicës dhe Pejës, gjykatat nuk kanë kërkuar ekzaminim psikiatrik *sipas detyrës zyrtare* dhe, përkundër vënies në dukje të gjendjes mendore së të pandehurve, kanë shqiptuar masën e paraburgimit. Siç u përmend më sipër, edhe prokuroria, megjithëse nuk kishte kërkuar të kryhej vlerësim psikiatrik, ka përmendur shqetësime në lidhje me shëndetin mendor të këtyre të pandehurve dhe, sipas informatave në dispozicion të OSBE-së, as mbrojtja nuk duket të ketë ngritur shqetësime apo të ketë kërkuar vlerësim.

Në rrethana si në rastet e mësipërme, nëse gjykata disponon me informata ose nëse ekziston dyshimi se personi vuan nga ndonjë çrregullim i shëndetit mendor, gjyqtari duhet të caktojë ekspert për të kryer ekzaminimin psikiatrik të pandehurit para shqiptimit të masës së paraburgimit.<sup>19</sup>

Në rastin e tretë nga rajoni i Gjakovës, mbrojtja e ka kundërshtuar kërkesën e prokurorit duke i përmendur problemet e shëndetit mendor të pandehurit. Më tej, mbrojtja ka propozuar masën alternative të trajtimit psikiatrik në Institutin e Psikiatrisë Forenzike me qëllim të stabilizimit të gjendjes mendore të pandehurit. Megjithatë, në vend të kësaj, gjykata ka urdhëruar që i pandehuri të dërgohet në paraburgim, duke arritur në përfundimin se i pandehuri mund ta marrë trajtimin adekuat në qendrën korrektuese. Faktor bindës për nxjerrjen e një aktvendimi të tillë ishte se ndaj të pandehurit tashmë kishte qenë urdhëruar trajtim.

Pasojë e drejtpërdrejtë dhe serioze e neglizhencës për të kërkuar ekzaminimin psikiatrik të një të pandehuri i cili dyshohet se vuan nga probleme të shëndetit mendor është se i pandehuri ka gjasë që të mbahet në një mjedis të papërshtatshëm ku do të privohej nga kujdesi thelbësor për shëndetin mendor. Mungesa ose papërshtatshmëria e trajtimit, që ndikon negativisht në shëndetin

---

<sup>19</sup> Neni 508(1) i KPP 2013.

mendor të këtyre të paraburgosurve, mund të ngre shqetësime serioze për trajtim çnjerëzor ose poshtërues.<sup>20</sup>

Në vetëm dy nga pesë rastet, prokurorët kanë kërkuar ekzaminimin psikiatrik të të pandehurve (një në rajonin e Gjilanit dhe një në rajonin e Gjakovës). Në të dyja rastet, mbrojtja është pajtuar me propozimin e prokurorisë, duke vënë në pah gjendjen jostabile të shëndetit mendor të klientëve të tyre, ndërsa gjykata ka urdhëruar më pas ekzaminimin psikiatrik të të pandehurve në fjalë. Rasti i shqyrtuar nga Gjykata Themelore në Gjilan është shembull i praktikës së mirë:

Duke u nisur nga informatat për problemet e shëndetit mendor nga të cilat vuante i pandehuri, prokurori ka kërkuar ekzaminim psikiatrik sipas nenit 508(1)(4) dhe (5) të KPP. Mbrojtja e ka mbështetur kërkesën e prokurorisë dhe ka nënvizuar se i pandehuri vuante prej kohësh nga probleme mendore dhe e kishte të nevojshme t'i nënshtrohej trajtimit të vazhdueshëm. Gjykata, pas dëgjimit të ekspertit psikiatrik, ka urdhëruar trajtim të detyrueshëm në Institutin e Psikiatrisë Forenzike në Prishtinë *"me synimin që gjatë kësaj periudhe [i pandehuri] të ekzaminohet dhe vëzhgohet"*. Në këtë rast, u pranua se kishte shqetësime serioze lidhur me shëndetin mendor të të pandehurit që kërkonin trajtim afatgjatë.

Vlen të përmendet se mungesa e shtretërve në Institutin e Psikiatrisë Forenzike i është raportuar OSBE-së si sfidë e vazhdueshme për trajtimin e rasteve me të pandehur me probleme të shëndetit mendor. Përkundër rinovimeve të fundit të Repartit D në Institutin e Psikiatrisë Forenzike, numri i shtretërve arrin të plotësojë vetëm gjysmën e kapacitetit të nevojshëm. Duke qenë se Instituti i Psikiatrisë Forenzike është i vetmi institucion në Kosovë që mund t'i trajtojë personat me nevoja të shëndetit mendor, mungesa e shtretërve i kufizon shumë opsionet gjyqësore në këtë drejtim. Megjithatë, duhet theksuar se mungesa e hapësirave të disponueshme në një institucion të përshtatshëm nuk mjafton për ta justifikuar vazhdimin e mbajtjes në paraburgim në burg të rëndomtë të një personi me probleme të rënda të shëndetit mendor.<sup>21</sup> Për çrregullimet më pak serioze, duhet

<sup>20</sup> Shih p.sh., Dybeku kundër Shqipërisë, GJEDNJ, Aktgjykimi i datës 18 dhjetor 2007; Raffray Taddei kundër Francës, GJEDNJ, Aktgjykimi i 21 dhjetorit 2010; G. kundër Francës, GJEDNJ, Aktgjykimi i 23 shkurtit 2012, MS kundër Mbretërisë së Bashkuar, GJEDNJ, Aktgjykimi i datës 3 maj 2012; Rooman kundër Belgjikës, GJEDNJ, Aktgjykimi i datës 31 janar 2019 (Dhoma e Madhe).

<sup>21</sup> *Sy kundër Italisë*, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Aktgjykimi i 24 janarit 2022, paragrafi 135.

të merret në konsideratë të paktën trajtimi në komunitet ose në reparte të specializuara mjekësore në qendrat korrektuese, varësisht nga disponueshmëria e trajtimeve dhe hapësirave të tilla të specializuara.

Si përmbledhje, është evidente se përqindja relativisht e lartë e të pandehurve me çrregullime mendore në mostrën prej 70 rastesh të monitoruara (shtatë për qind) sugjeron fuqimisht nevojën për investime në këto shërbime.

## 5. Përmbyllje

Në analizën e rasteve të shqyrtuara nga gjykatat themelore të Kosovës ku të pandehurit ishin persona me probleme të shëndetit mendor, OSBE ka evidentuar shqetësime të veçanta për sa i përket procedurës për shqiptim të paraburgimit. Më konkretisht, OSBE vëren se, përkundër ekzistimit të dyshimit apo informatave për gjendjen mendore të të pandehurit, në shumicën e rasteve nuk është kryer ekzaminimi psikiatrik para nxjerrjes së aktvendimit për shqiptim të paraburgimit. Kjo është në kundërshtim me procedurën e rekomandueshme të paraparë me KPP dhe standardet ndërkombëtare. Si rrjedhim, të pandehurve të cilëve nuk u është vlerësuar shëndeti mendor nuk u ofrohen trajtimet dhe kushtet adekuate. Kjo jo vetëm që përbën shkelje të dispozitave përkatëse të KPP-së, por në situata më serioze, ngre shqetësime në kuptim të trajtimit çnjerëzor dhe poshtërues sipas nenit 3 të KEDNJ.





## Për Ministrinë e Drejtësisë

- Të merret parasysh miratimi i plotësim-ndryshimeve ligjore për të paraparë vlerësimin psikiatrik të detyrueshëm të çdo të pandehuri që shfaq shenja të problemeve të shëndetit mendor sapo të ketë dyshime ose informacione për këtë gjë.
- Të bashkërendohet me ministrinë e tjera për të siguruar burime të mjaftueshme për shërbimet e shëndetit mendor ashtu që të mundësohet vlerësimi i hershëm i të pandehurve me probleme të shëndetit mendor dhe diversioni nga sistemi i rregullt i drejtësisë penale aty ku është e përshtatshme, përfshirë sigurimin e numrit të mjaftueshëm të shtretërve në dispozicion për të përmbushur nevojën për trajtim në Institutin e Psikiatrisë Forenzike; si dhe të merret parasysh krijimi i reparteve të specializuara mjekësore në qendrat e paraburgimit për të ofruar trajtim për të paraburgosurit me çrregullime më pak të rënda.



